

RELACION

Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e parë të vitit 2013

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Per buxhetin e shtetit për vitin 2013”, Udhezimit nr. 1 datë 03.01.2013 “Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin”

dhe Udhezimit nr.2 datë 06.02.2013 “Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2013”, i është akorduar një fond i planifikuar prej 117 milione e 900 mijë lekë, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	11,000,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	1,700,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	7,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	96,700,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,500,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	117,900,000 LEKE

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **26,701,344 leke** nga totali prej **117,900,000 Leke** ose **22.64%** të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.

Gjatë 3- mujorit të pare të vitit 2013, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 punonjes.

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

2,446,210 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **22.23 %**.

411,089 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **24.18%**.

Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2011, është planifikuar ne vlerën 7,000,000 leke. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **1,162,045 Lekë** ose **16.6%** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në nje shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, te detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, sherbime postare e telefonike falas per publikun, ne funksion te nje veprimtarie normale institucionale.

- Kyerjen e te gjitha blerjeve per nevoja te AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.

- Kryerjen e pagesave per likuidimin e detyrimeve furnitore dhe te trete, te mbartura nga 2012.

Fondi në zerin per Transferime Korrente te Brendshme (zeri 604), per vitin 2012 është planifikuar ne vlerën 96,700,000 leke. Ky eshte dhe zeri me me peshe ne strukturen e buxhetit te AMSHC, duke qene se dhe vete misioni i ketij institucioni ka si qellim kryesor financimin e Shoqerise Civile me Grante per projektpropozimet te OJF perfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **22,682,000 Lekë** ose **23.45 %** e planit vjetor.

Në realizimin e ketij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet per këstin e dyte (40%) e thirrjes së tretë, me pjesen e trete(10%) dhe te Granteve te miratuara dhe te kontraktuara ne vitin 2010 dhe 2011, per Organizatat Jo-Qeveritare perfituese te financimit me Grante.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

1,500,000 Lekë (zeri 231) për Investime te Trupezuara, realizimi **0%**.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

Drejtor Ekzekutiv

RUDI BOBRATI